



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 3 janar 2020
Nr. ref.:RK 1494/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI28/19

Parashtrues

Lutfi Morina

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit
Ac.nr.4035/18 i 5 tetorit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Lutfi Morina nga Klina (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës [Ac.nr.4035/18] të 5 tetorit 2018 në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Klinë [C.nr.305/18] i 22 gushtit 2018.
3. Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit të Kosovës [Ac.nr.4035/18] i 5 tetorit 2018, i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 22 tetor 2018.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E drejta për një Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 20, 47 dhe 48 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 8 shkurt 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 15 shkurt 2019, Kryetarja e Gjykatës e caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.
8. Më 19 prill 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrim të kërkesës dhe kërkoi nga ai që ta plotëson formularin e kërkesës në pajtim me rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës. Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës së Apelit.
9. Më 7 maj 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi formularin e plotësuar në pajtim me rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës.
10. Më 27 nëntor 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Nga dokumentet e përfshira në kërkesë, rezulton se parashtruesi i kërkesës kishte pasur mosmarrëveshje me bashkëshorten e tij që në fund ishin adresuar në gjykatat e rregullta të Republikës së Kosovës.
12. Në një datë të paspecifikuar, bashkëshortja e parashtruesit të kërkesës A.M., bazuar në Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (LMDHF) kishte kërkuar nga Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Klinë lëshimin e urdhrit mbrojtës kundër parashtruesit të kërkesës me pretendimin për mbrojtje nga dhuna fizike dhe psikike.
13. Më 22 gusht 2018, Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Klinë (Aktvendim C.nr.305/18) kishte aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesën e A.M. dhe, mes tjerash, kishte përcaktuar: (i) që parashtruesit të kërkesës t'i ndalohet afrimi palës së mbrojtur A.M.; (ii) që parashtruesi i kërkesës të obligohet që të paguajë alimentacion në shumën prej 150 euro në muaj për mbajtje të fëmijëve të mitur; (iii) të urdhërohet parashtruesi i kërkesës që t'ia mundësojë palës së mbrojtur A.M. që t'i merr gjësendet personale nën shoqërimin e zyrtarëve policor; (iv) kohëzgjatja e urdhrit për mbrojtje është 6 muaj nga dita e lëshimit të tij dhe (v) moszbatimi i urdhrit për mbrojtje, paraqet vepër penale.
14. Pas dëgjimit të dëshmitarëve dhe vlerësimit të provave, Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Klinë konstatoi se parashtruesi i kërkesës ndaj palës së mbrojtur A.M., për trembëdhjetë (13) vite kishte shkaktuar dhunë fizike e psikike që ishte karakterizuar edhe me kërcënime se A.M. do të qëllohet me armë, çka në fund, kishte rezultuar me shkoputje faktike të bashkësisë martesore dhe strehim të palës së mbrojtur A.M. së bashku me fëmijët tek prindërit e saj.
15. Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Klinë pas dëgjimit të palëve ndërgjyqëse, përfaqësuesit për mbrojtje të viktimave, përfaqësuesit të Qendrës për punë sociale Klinë dhe dëshmitarëve R.Z., Z.K., E.M. dhe F.M. kishte vërtetuar gjendjen faktike që flet për përkeqësim të raporteve bashkëshortore të palëve ndërgjyqëse si pasojë e "xhelozisë së ulët" që kishte parashtruesi i kërkesës ndaj A.M. duke ia kufizuar asaj "daljen nga banesa" dhe "qarkullimin e lirshëm" për më shumë se trembëdhjetë (13) vjet.
16. Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Klinë po ashtu kishte refuzuar kërkesën e palës së mbrojtur për heqje të përkohshme të së drejtës prindërore të parashtruesit të kërkesës sepse nuk ishte vërtetuar se ai ka keqpërdorur të drejtën prindërore; mirëpo, po ashtu kishte shtuar se urdhri për mbrojtje duhet kuptuar si mjet parandalues dhe vërejtje në lidhje me pasojat ligjore për parashtruesin e kërkesës nëse përsërit sjelljet e tij.
17. Më 29 gusht 2018, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit duke goditur aktvendimin e lartpërmendur të Gjykatës Themelore me pretendim të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, shkeljes së Konventës për të Drejtat e Fëmijëve dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që aktvendimi i goditur të ndryshohet ose të prishet dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rishqyrtim si dhe të refuzohet e pabazuar kërkesa e palës së mbrojtur A.M.

18. Në ankesën e paraqitur në Gjykatën e Apelit, parashtruesi i kërkesës kishte pretenduar se e mitura E.L. ishte marrë në pyetje në cilësinë e dëshmitares në mënyrë të kundërligjshme nga gjykata e shkallës së parë sepse në seancën e 22 gushtit 2018 ajo akoma nuk i kishte mbushur katërmëdhjetë (14) vjet, çka është në kundërshtim me nenin 128 të Kodit të Procedurës Penale, Kushtetutës, Konventës për të Drejtat e Fëmijëve dhe KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës kishte pohuar se neni 128 i Kodit të Procedurës Penale ndalon pyetjen e fëmijëve nën moshën 14 vjeçare; dhe fakti që ligji i procedurës kontestimore nuk parashikon ndalesë për dëshmitarët e mitur, tregon se aktvendimi i goditur është i kundërligjshëm sepse është bazuar në prova të papranueshme sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijëve dhe KEDNJ-së.
19. Më 5 tetor 2018, Gjykata e Apelit (Aktvendim Ac. Nr. 4035/18) refuzoi të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës ndërsa Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.305/18 të 22 gushtit 2018, e vërtetoi. Gjykata e Apelit arsyetoi: (i) se aktvendimi i gjykatës themelore është i drejtë dhe i ligjshëm sepse nuk karakterizohet nga shkelje thelbësore të procedurës kontestimore; (ii) se aktvendimi i goditur ndjek qëllimin e LMDHF-së për parandalim të dhunës në familje në të gjitha format e saj, dhe se, (iii) aktvendimi i goditur ka arritur të sigurojë dhe ofrojë mbrojtje adekuate palës së mbrojtur dhe fëmijëve, siç parashikon Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.
20. Pjesa relevante e aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës së Apelit përcakton:

“Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vendosur kur ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar, pasi që një vendim i tillë është në përputhje të plotë me gjendjen faktike, e pasi që gjykata gjatë procedurës, respektivisht në seancën dëgjimore ka bërë dëgjimin e palëve ndërgjyqëse në cilësinë e palëve, dëshmitë e dëshmitarëve, në bazë të të cilave prova ka rezultuar se pala përgjegjëse ka ushtruar dhunë psikike ndaj palës së mbrojtur duke shprehur shenja xhelozie ndaj palës së mbrojtur dhe në këtë mënyrë ia ka kufizuar dhe ndaluar lëvizjen e lirë të saj, respektivisht daljen nga banesa dhe qarkullimin e lirshëm, e që këtë e ka bërë në mënyrë të vazhdueshme 13 vite e kënde, nga e cila dhunë pala e mbrojtur ishte detyruar edhe të largohet nga shtëpia, ku për raportet e vazhdueshme të përkeqësuar të palëve ndërgjyqëse e pohojnë edhe dëshmitarët e dëgjuar në seancë dëgjimore, andaj edhe gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktvendimit ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur lidhur me themelësinë e kërkesës për urdhër mbrojtje [...]. Lidhur me mënyrën e vendosjes si në piken 4 dhe 5 të pjesës së II (dytë) të dispozitivit të aktvendimit të atakuar, e që ka të bëjë me caktimin e kujdestarisë, besimin e fëmijës dhe kontaktin me palën përgjegjëse, gjykata e shkallës së parë ka vendosur duke marrë parasysh mendimin e Qendrës për Punë Sociale me çka edhe ka vendosur që fëmijët e mitur EM, AM dhe JM, përkohësisht t'i besohen palës së mbrojtur AM, për arsye se është në interesin më të mirë të fëmijëve se mitur, lidhjen emocionale me nënën, nevojat për kujdes specifik, të cilin nëna e ushtron ndaj fëmijut, e në veçanti duke marrë për bazë faktin se

fëmijët e mitur janë të moshës se vogël ku është i domosdoshëm kujdesi i nënës për rritjen dhe përkujdesjen e fëmijëve, andaj edhe ka vlerësuar se është në interes më të mirë të fëmijëve, duke pasur parasysh gjendjen emocionale të fëmijëve, moshën e tyre, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit [Ac. Nr. 4035/18] i 5 tetorit 2018 dhe Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Klinë [C.nr.305/18] i 22 gushtit 2018 shkelin të drejtat e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuara me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së.
22. Parashtruesi i kërkesës pretendon: “[...] Gjykata e Apelit nuk ka arsyetuar aktvendimin e kontestuar në raport me pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës të paraqitura në ankesën e 29 gushtit 2018, e cila është ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore të Pejës-Dega Klinë, C.nr.305/18 të datës 22.08.2018”.
23. Për sa i përket obligimit të gjykatave për të arsyetuar vendimet e tyre, parashtruesi i kërkesës i referohet vendimeve të GJEDNJ-së *Tatishvilli kundër Ruisë, Hadjianastassiou kundër Greqisë* si dhe aktgjykimit të kësaj Gjykate në rastin nr. KI97/16 me parashtrues *IKK Classic*.
24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se neni 128 i Kodit të Procedurës Penale ndalon marrjen në pyetje të fëmijëve nën moshën 14 vjeç dhe fakti që ligji i procedurës kontestimore nuk parashikon ndalesë për dëshmitarët e mitur tregon se aktvendimet e gjykatave të rregullta janë të kundërligjshme sepse janë bazuar në prova të papranueshme sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijëve dhe KEDNJ-së.
25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit nuk është përgjigjur ndaj pretendimeve ankimore: (i) se aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Klinë ka qenë i kundërligjshëm sepse është bazuar në prova të papranueshme në kundërshtim me Konventën për Fëmijë dhe GJEDNJ; (ii) se aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Klinë ka vënë parashtruesin e kërkesës në pozitë të pabarabartë karshi palës së mbrojtur A.M. sepse nuk ka administruar provat e favorshme për parashtruesin e kërkesës dhe, (iii) në mënyrë të kundërligjshme ka përjashtuar avokatin e parashtruesit të kërkesës nga seanca shqyrtuese dhe nuk ka evidentuar procesverbalet e seancës së 22 gushtit 2018.
26. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: (i) që kërkesën e tij ta shpallë të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; (iii) ta shpallë të pavlefshëm Aktvendimin e Gjykatës së Apelit Ac. nr.4035/18 të 5 tetorit 2018 dhe, (iv) ta kthejë në rishqyrtim Aktvendimin e Gjykatës së Apelit Ac. nr.4035/18 të 5 tetorit 2018.

Dispozitat relevante ligjore

LIGJI PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE Nr. 03/L-182

Neni 20 Ndryshimi, ndërprerja dhe vazhdimi i urdhër mbrojtjes

1. Kur rrethanat kanë ndryshuar, pala e mbrojtur ose kryesi i dhunës mund t'i parashtrojë kërkesë gjykatës, për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrit për mbrojtje, me ç'rast gjykata mund të vendosë që urdhri për mbrojtje:

1.1. të mbetet në fuqi;

1.2. të ndryshohet;

1.3. të ndërpritet, nëse gjykata vlerëson se kanë pushuar të gjitha shkaqet mbi bazën e të cilave është shqiptuar urdhri mbrojtës.

2. Parashtrimi i kërkesës për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrit për mbrojtje, nuk e ndalon ekzekutimin e urdhrit për mbrojtje.

3. Pesëmbëdhjetë ditë para skadimit të urdhrit për mbrojtje, pala e mbrojtur ose përfaqësuesi i autorizuar, mund të parashtrojë kërkesën për vazhdimin e urdhrit për mbrojtje. Nëse nuk parashtrohet kërkesa për vazhdimin e urdhrit për mbrojtje, ai ndërpritet menjëherë në ditën e skadimit.

4. Pas marrjes së kërkesës për vazhdimin e urdhrit për mbrojtje, gjykata mund:

4.1. të ndërpres urdhrin për mbrojtje në datën e skadimit të tij; ose

4.2. të vendosë që të vazhdohet urdhri për mbrojtje, nëse nuk kanë pushuar shkaqet mbi bazën e të cilave është shqiptuar masa mbrojtëse.

LIGJI PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE Nr. 03/L-006

DËSHMITARËT

Neni 339

339.1 Çdo person që thirret si dëshmitar ka për detyrë t'i përgjigjet thirrjes, e në qoftë se me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe, ka për detyrë edhe të dëshmojë.

339.2 Si dëshmitar mund të pyetën vetëm personat që kanë aftësi të japin informata mbi faktet që duhet të provohen.

339.3 Të miturit nën katërmbëdhjetë vjeç mund të pyeten si dëshmitar vetëm kur thëniet e tyre janë të domosdoshme për zgjidhjen e çështjes.

Neni 140. Vendimi i gjykatës për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave prindërore

[...]

(5) Mendimi i fëmijës, i cili është i aftë të japë pikëpamjet e tij/saj, do të merret parasysh nga gjykata në çdo procedurë që i përket atij. Mendimit të tij do t'i jepet pesha e duhur në pajtim me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.

Pranueshmëria e kërkesës

27. Gjkata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuar me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
28. Gjkata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjkata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

29. Gjkata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjkata së pari i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që parashikojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjkata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... .”

30. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [Ac. Nr. 4035/18] të 5 tetorit 2018 të Gjykatës së Apelit, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

31. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të specifikuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës specifikon kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2) specifikon:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

32. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së me pretendimin se gjykatat e rregullta: (i) kanë nxjerrë vendimet e tyre bazuar në dëshmi të papranueshme; (ii) kanë vënë parashtruesin e kërkesës në pozitë të pabarabartë me palën kundërshtare dhe, (iii) nuk kanë arsyetuar përjashtimin e avokatit të parashtruesit të kërkesës nga seanca shqyrtuese.

33. Në adresimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata thekson që pretendimet thelbësore të parashtruesve të kërkesës, që kanë të bëjnë me shkeljet e pretenduara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, janë interpretuar detajisht përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Rrjedhimisht, në interpretimin e pretendimeve për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata do t'i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

34. Gjykata vëren se praktika e GJEDNJ-së thekson se drejtësia e një procedure vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 6 dhjetorit 1988, *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, nr. 10590/83, paragrafi 68). Rrjedhimisht, gjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do t'i përmbahet këtij parimi (shih gjithashtu, rastin e Gjykatës KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić*, Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 38; dhe rastin KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018, paragrafi 31).

35. Për sa i përket pretendimit për pranim të dëshmive të papranueshme, Gjykata vëren se kërkesa e “drejtësisë” siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës mbulon procedurat në tërësi, dhe pyetja nëse një person ka pasur një gjykim “të drejtë” shikohet me anë të analizës kumulative të të gjitha fazave, jo thjesht i një incidenti të veçantë ose mangësie procedurale, ngase mangësitë e tilla në një fazë mund të korrigjohen në një fazë të mëvonshme (shih, për shembull, *Monnell dhe Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafët 55-70).

36. Sa i përket pretendimit se neni 128 i KPK-së parashikon ndalimin e marrjes në pyetje të fëmijëve nën moshën 14 vjeç dhe se një ndalesë e tillë nuk është parashikuar me ligjin e procedurës kontestimore, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës materiale dhe procedurale (shih rastin *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe shih, gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

37. Veç kësaj, Kushtetuta dhe KEDNJ-ja nuk parashikojnë rregulla për dëshmitë në kuptimin e saktë të asaj fjale (shih, *Mantovanelli kundër Francës*, paragrafi 34). Pranueshmëria e dëshmive dhe mënyra e vlerësimit të tyre janë çështje kryesisht të rregulluara nga ligjet e vendit dhe gjykatat e rregullta (shih, *Moreira de Azevedo kundër Portugalisë*, paragrafët 83-84; dhe *García Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 28). Megjithatë, detyra e Gjykatës, bazuar në Kushtetutë dhe KEDNJ, është që të vërtetojë nëse procedurat si tërësi kanë qenë të drejta, përfshirë dhe mënyrën se si janë pranuar dëshmitë (shih, *Elsholz kundër Gjermanisë* [DHM], paragrafi 66; dhe *Devinar kundër Sllovenisë*, paragrafi 45). Prandaj, duhet përcaktuar nëse dëshmitë janë pranuar ashtu që të garantojnë një proces të rregullt (shih, *Blücher kundër Republikës Çeke*, paragrafi 65).

38. Në këtë drejtim, për sa i përket dëshmisë së të miturës E.L., Gjykata vëren se gjykatat e rregullta kanë vërtetuar gjendjen faktike duke u bazuar në dëshmitë e shumë dëshmitarëve të tjerë (shih më lart paragrafi 16). Çka tregon se

dëshmia e të miturës E.L. nuk ka qenë dëshmi e vetme apo kryesore që ka mundur ta influencojë rezultatin e rastit apo kushtetutshmërinë e procesit si tërësi (shih, anasjelltas, *Ruiz Torija kundër Spanjës*, paragrafi 30; dhe *Hiro Balani kundër Spanjës*, paragrafi 28).

39. Veç kësaj, Gjykata vëren se dispozitat përkatëse të kuadrit ligjor në Republikën e Kosovës lejojnë gjykatat që t'i marrin në pyetje edhe të miturit dhe se ato kanë diskrecion për të vlerësuar nëse një i mitur do të merret në pyetje ose jo (shih nenin 339.3 të Ligjit për Procedurë Kontestimore Nr. 03/L-006 dhe nenin 140.5 të Ligjit për Familje Nr. 2004/32). Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se si rregull i përgjithshëm, nuk është detyrë e saj ta zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta (shih, *mutatis mutandis*, *Dombo dhe Beheer kundër Hollandës*, paragrafi 31).
40. Për sa i përket pretendimit për mos arsyetim të përjashtimit të avokatit nga seanca shqyrtuese, Gjykata vëren se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së obligojnë gjykatat që të japin arsye për vendimet e tyre, mirëpo ky obligim nuk mund të kuptohet si kërkesë për të dhënë përgjigje të detajuar ndaj çdo argumenti (shih, *Van de Hurk kundër Holandës*, paragrafi 61; *García Ruiz*, cituar më lart, paragrafi 26; *Jahnke dhe Lenoble kundër Francës* (Aktvendim); dhe *Perez kundër Francës* [DHM], paragrafi 81).
41. Veç kësaj, nga substanca e rastit nën shqyrtim, rezulton se largimi i avokatit nga seanca e 22 gushtit 2018, nuk ka qenë zhvillim vendimtar në gjendje që ta influencojë rezultatin përfundimtar apo të cenojë procesin e rregullt ligjor si tërësi, aq më tepër, kur nuk është provuar se avokati është larguar në mënyrë të kundërligjshme (shih, anasjelltas, *Ruiz Torija dhe Hiro Balani*, cituar më lart).
42. Shikuar procesin e zhvilluar si tërësi, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta, pas vlerësimit të provave dhe dëgjimit të dëshmitarëve kanë konstatuar: (i) rrezikshmërinë e veprimeve të parashtruesit të kërkesës ndaj palës së mbrojtur çka ka rezultuar me caktim të urdhrit për mbrojtje; (ii) kanë shpjeguar natyrën parandaluese të urdhrit mbrojtës dhe qëllimin legjitim që ndjek urdhri në fjalë; (iii) kanë refuzuar kërkesën e palës së mbrojtur për heqjen e të drejtës prindërore të parashtruesit të kërkesës dhe (iv) kanë caktuar lartësinë e alimentacionit në pajtim me gjendjen ekonomike të parashtruesit të kërkesës.
43. Gjykata vëren se parashtruesit të kërkesës i është mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; se ai ka mundur që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqiste argumente dhe dëshmi që ai i konsideronte relevante për rastin e tij; se atij i është dhënë mundësia që të kontestojë në mënyrë efektive argumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga pala kundërshtare; se të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tij janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura ishin shtruar hollësisht dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës Nr. KI118/17, Parashtrues *Sani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 shkurtit 2018, paragrafi 35; po ashtu shih, *mutatis mutandis*, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 29).

44. Gjykata thekson se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk përcaktojnë që Gjykata ta vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta në një kontest civil, ku zakonisht njëra prej palëve në procedurë fiton dhe tjetra humb (shih, KI118/17, cituar më lart; po ashtu shih, rastin e Gjykatës Nr. KI142/15, parashtrues *Habib Makiqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 1 nëntorit 2016, paragrafi 43).
45. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurës në gjykatat e rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe shih, gjithashtu, rastin KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).
46. Sa më sipër, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, ankesa nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendim i 30 qershorit 2009).
47. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe duhet të shpallet e papranueshme, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, parashihet me nenin 20 të Ligjit dhe specifikohet më tej me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 27 nëntor 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues

Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

